




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 19 – 7541 – 236/C227
14 Nr. 1222/19
Dt. 14.11.2019

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. **KOMPANIA E SIGURIMEVE “ ILLYRIA ”SH.A.** me seli në Prishtinë, me ARBK : 810483796, si **Operator Ekonomik**, të cilën e përfaqëson **z. Lendi Kadriji**, në tekstin e mëtejme **KONTRAKTUESI – KRYESI I SHËRBIMIT**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë për ekzekutimin e shërbimeve, si vijon:

Shërbime të Sigurimit Shëndetësorë të nxënësve gjatë praktikës profesionale, me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	75	4	1	2	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	1	1	9	2	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime të Sigurimit Shëndetësor të nxënësve të SHMT “ Lutfi Musiqi “ dhe SHMP “ Bahri Haxha “ gjatë praktikës profesionale**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-19-119-236
- 1.2 Kjo kontratë është **Kontratë Publike Kornizë** dhe zbatimi i sajë do të përfshijë periudhën nga dt. **01.Dhjetor 2019 dhe përfundimisht deri më 30 Qershor 2020.**
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë shërbime në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Kontraktuesi , duke specifikuar listën me nxënës që do të vijojnë praktikën profesionale dhe që do të mbulohen me Sigurimin Shëndetësorë.
- 1.4 Sasitë e parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mundë të lejohet një mospërputhje e cila nuk mundë të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind (30 %).
- 1.5 Nëse Urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Ekzekutimi i shërbimeve do të filloi menjëherë pas lëshimit të Polisës së Sigurimeve Shëndetësore.
- 2.2 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i njësisë së shërbimeve është paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Kontraktuesi – Kryesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i njësisë (Sigurimi Shëndetësorë për një nxënës, për një muaj për një nxënës është: 0,47€ ndërsa çmimi tetë mujorë për një nxënës është 3.76€.

3.3. Vlera totale indikativë e Kontratës Kornizë është: 4.136,00€ (katërmijnjëqindtridhjetgjashtë/00 Euro).

3.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

3.4 Pagesat do të bëhen : në baza mujore, në pajtim me numrin e nxënësve për të cilët është lëshuar Polisa e Sigurimit Aksidental, sipas porosisë të aprovuar nga Menaxheri i Kontratës i A.K. të cilat duhen të jenë të pasqyruara në Regjistrin e nxënësve që kanë vijuar praktikën profesionale. Shërbimet e porositura duhen përfunduar në kohë, në mënyrë cilësore dhe sasiore, duke respektuar kushtet e kontratës dhe Specifikat Teknike, pjesë përbërëse e kësaj kontrate, si dhe Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Personave nga Pasojat e Aksidenteve si dhe Kushtet Plotësuese për Sigurimin e nxënësve dhe Studentëve nga pasojat e aksidenteve.

Shumat do të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kësaj Kontrate si dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e Dosjes së Tenderit.

3.5. Kontraktuesi ka për obligim që me rastin e fillimit të ekzekutimit të shërbimeve të lëshoi Polisën e Sigurimit Shëndetësor për periudhën e saktësuar në nenin 1.2 të kësaj Kontrate Kornizë, e cila do të jetë e nënshkruar nga të dyja palët kontraktuese. Shtojcë e Polisës së Sigurimit Shëndetësor do të jetë detyrimisht edhe Regjistri i nxënësve të Siguruar të të dy shkollave të mesme profesionale të saktësuar në nenin 1.1 të kësaj Kontrate, të cilët janë të përfshirë në praktikën profesionale. Shërbimet mbuluara dhe të kontraktuara sipas kësaj kontrate duhen të jenë në përshtatshmëri të plotë me kushte e kontratës, të përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin :

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj	Emri:	Lendi Kadriji
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik	Pozita:	Zyrtar i Marrjes në Sigurim
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.11.2019	Data:	14.11.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Komuna e Vushtrisë planifikon të lidhë kontratë për Shërbimet e Sigurimit shëndetësor për nxënësit gjatë kryerjes së praktikës profesionale për periudhën 8 mujore Nëntor 2019 - Qershor 2020 .
2. Numri i planifikuar i nxënësve të cilët do të përfitojnë nga shërbimet shëndetësore është 1100 .
3. Pagesa nga Autoriteti Kontraktues do të bëhet në baza mujore, sipas numrit të nxënësve të aprovuar nga menaxheri i kontratës.
4. Afati kohor i ri-mbursimit të shpenzimeve të bëra nga klienti nuk mund të jetë më i gjatë se **njëzet ditë (20) ditë** duke filluar nga data kur Klienti e ka dorëzuar kërkesën për kompensim.
4. Afati për pranimin e kërkesave për ri-mburesim për gjatë periudhës së sigurimit duhet të jetë deri në **60 ditë** pas skadimit të kontratës.
6. Në tabelën e mëposhtme janë shënuar shërbimet të cilat do të mbulohen me sigurim:

Nr	Përshkrimi i shërbimeve të cilat do të mbulohen me sigurim nga OE	Mbulimi
1	Një gjymtyrë të sipërme	Djathtë 70% dhe Majtë 60%
2	Një dore ose parakrah	Djathtë 60% dhe Majtë 50%
3	Një gisht të madh	Djathtë 75% dhe Majtë 70%
4	Një gisht tregues	Djathtë 75% dhe Majtë 70%
5	Një gisht të mesëm	Djathtë 75 % dhe Majtë 70%
6	Një gisht tjetër	Djathtë 75 % dhe Majtë 70%
7	Një gisht të vogël të dorës apo të këmbës	Djathtë 75 % dhe Majtë 70%
8	Një falange të gishtit të madh	Djathtë 75 % dhe Majtë 70%
9	Një falange të gishtit tjetër 1/3 e gishtit	Djathtë 75 % dhe Majtë 70%
10	Një gisht të madh të këmbës	75%
11	Një gisht tjetër të këmbës	75%
12	Një këmbë mbi gju	60%
13	Një këmbë nën gju	50%


Numri i Prokurimit: VU644-19-7541-2-3-6 – Titulli Sherbimet e Sigurimit shëndetësor i nxënësve gjatë praktikës profesionale

14	Një këmbë	40%
15	Dy këmbët	100%
16	Shikimi në dy sytë	100%
17	Shikimi në një sy	70%
18	Dëgjimi në dy veshët	60%
19	Dëgjimi në një vesh	70 %
20	Humbjen e zërit	30%
21	Ngushtimin hundur të njëanshëm	60%
22	Ndrydhjen e vertebrave	70%
23	Vertebrat kurrizore	70 %
24	E 12-ta kurrizore	70 %
25	Kryqe	70 %

2019-119-Shërbimet e sigurimit shëndetësor të nxënësve gjatë praktikës profesionale

Shënimimi: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonen E
Çmimin duhet ta shkruani vetëm me dy decimale pas presjes dhjetore.

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali (me TVSH)-€
1	Shërbimet e sigurimit shëndetësor të nxënësve gjatë praktikës profesionale	Nr. I nxënësve	1100	3.76	4,136.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM:					4,136.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	KS ILLYRIA Sh.a
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Lendi Kadriji - Zyratari i Marrjes ne Sigurim
NËNSHKRIMI:	
DATA:	10.10.2019
VULA:	